

PhDc. Gea SULO

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë

FIGURA E ISMAIL QEMALIT NË FONDIN 20 TË AQSH

Abstrakt: Në këtë artikull kemi zgjedhur të flasim për një figurë të madhe historike, e cila ka lënë gjurmë gjatë rrjedhës së saj, figurën e Ismail Qemalit. Në Historinë e Shqipërisë dhe të popullit shqiptar ka shumë data dhe figura historike që kanë lënë gjurmë gjatë rrjedhës së saj. Pikërisht për këtë arsye dhe unë sot do mundohem që shkurtimisht të jap një panoramë mbi atë se çfarë burimesh dokumentare rruhen sot për sot në fondet e AQSH, për figurën e Ismail Qemalit.

Fjalë kyçe: *burime dokumentare, Ismail Qemali, histori e Shqipërisë, Pavarësia e Shqipërisë, fonde arkivore.*

Në Historinë e Shqipërisë dhe të popullit Shqiptar ka shumë data dhe figura historike që kanë lënë gjurmë gjatë rrjedhës së saj. Por 12 nëntori dhe Ismail Qemali është një datë dhe një emër që kanë shënjuar historinë tonë kombëtare. Pikërisht për këtë arsye do të mundohem që shkurtimisht të jap një panoramë mbi atë se çfarë burimesh dokumentare ruhen sot për sot në fondet e AQSH, për figurën e Ismail Qemalit.

Ismail Qemali lindi më 24 janar 1844 në qytetin e Vlorës. Ishin prindërit e tij: Mahmut Beu, babai, dhe Hedije Hanëmi, nëna që u kujdesën që ai të merrte një arsim sa më të mirë, me të vetmin qëllim që ai të bëhej një “shqiptar i plotë”¹.

Shkollën fillore I. Qemali e mbaroi në Selanik, ku familja qëndroi për pothuajse 3 vjet si të internuar nga administrata osmane. Pas faljes që u bëri Sulltani të internuarve, ai kthehet në Shqipëri, për të vazhduar shkollën e mesme në Janinë, në gjimnazin Zosimea, dhe prej aty do të largohet në maj të 1860 për të filluar punë në Stamboll si fillim në zyrën e përkthimeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme², dhe më vonë po si përkthyes në zyrën e përkthimeve në Portën e Lartë³.

¹ Skënder Luarasi, *Ismail Qemali, Jeta dhe vepra*, fq. 11.

² Pak vite pasi erdhi për herë të parë në Stamboll, I. Qemali rikthehet në Janinë si ndihmës drejtor i punëve politike dhe 1864 martohet për herë të parë. Ishte vetëm 20 vjeç.

³ Skënder Luarasi, *Ismail Qemali, Jeta dhe vepra*, fq. 11-17.

Gjatë viteve në vazhdim I. Qemali do të punojë në poste të ndryshme të administratës së lartë osmane. Për një periudhë të shkurtër I. Qemali ishte Prefekt në Galipoli, më pas në Bejrut e kështu me radhë. Nga Bejruti do të kthehet në Stamboll ku qëndroi deri në fund të shek XIX⁴.

Sipas studimit të S. Luarasi del se si nëpunës i Perandorisë Osmane, I. Qemali u lidh me rrethe shoqërore të cilat nuk vlerësonin metodat e vjetra të administrimit dhe të sundimit Osman. Janë transferimet e shumta ato që bënë që I. Qemali të njohë gjendjen e vërtetë të shoqërisë së asaj kohe, të kombësive jo-turke dhe të krijojë bindjen për nevojën e ndryshimeve rrënjësore. Ai jo vetëm e kuptoi situatën, por edhe vetë u bashkua me forcat që përkrahnin transformimin duke u bërë dhe zëdhënës i tyre⁵.

Ndonëse faktet mbi veprimtarinë patriotike para vitit 1900 janë të pakta, janë ato janë të mjaftueshme për të treguar se e gjithë kjo periudhë ishte si një fazë përgatitore për atë që I. Qemali do të bëjë më vonë. Ismail Qemali largohet nga Turqia jo që të kthehej përsëri në Turqi, por që t'i kthehej Shqipërisë e popullit të tij, thekson S. Luarasi në studimin e tij.⁶

Shkrimi i historisë së çdo kombi është e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me shfrytëzimin e arkivave, ku siç dihet grumbullohen ruhen përpunohen dhe prezantohen dokumentet që përbejnë kujtesën e një kombi. Ndër detyrat e shumta që ka ky institucion, një prej tyre, shumë i rëndësishëm dhe ky, është bërja e gjithë dokumentacionit arkivor sa më të aksesueshëm për këdo që është i interesuar.

Në morinë e mbi 200 milionë dokumenteve arkivore që lidhen me Shqipërinë dhe Shqiptarët, një vend të rëndësishëm në Arkivin Shqiptar zënë dhe dokumentet që i përkasin Ismail Qemalit dhe Qeverisë së Vlorës.

Sot këto dokumente janë të aksesueshme fizikisht, dhe shumë prej tyre janë në proces të dixhitalizimit, me qëllim lehtësimin e shfrytëzimit të tyre. Konkretisht në fondin arkivor “Kryesia e Qeverisë së Vlorës” aktualisht përmbledhet në 7 kuti, nga të cilat po dixhitalizohen dhe përkthehen i mbi 50 % e tyre.

Në përgjithësi studiuesit e dinë që Fondi 20 i përket figurës së Ismail Qemalit, pavarësisht se për këtë figurë dhe veprimtarinë e tij, direkt ose indirekt, gjenden të shpërndara shumë dokumente në fonde të tjera, dhe kryesisht tek fondi i Qeverisë së Vlorës.

Fondi 20 sot përbëhet nga 5 kuti me dokumente nga të cilat 60% janë dixhitalizuar dhe rreth 70% e tyre e përkthyer nga gjuhët të huaja. Ky

⁴ Skënder Luarasi, *Ismail Qemali, Jeta dhe vepra*, fq. 27.

⁵ Skënder Luarasi, *Ismail Qemali, Jeta dhe vepra*, fq. 30.

⁶ Skënder Luarasi, *Ismail Qemali, Jeta dhe vepra*, fq. 32.

fond përmban dokumente që lidhen kryesisht vetëm me jetën personale dhe veprimtarinë e Ismail Qemalit para, gjatë dhe pas Shpalljes së Pavarësisë. Në të bëjnë pjesë korrespondenca personale dhe zyrtare, duke filluar që nga shek. XVIII.

Duke bërë një renditje kronologjike dhe jo tematike, me synimin e vetëm dhënien e një informacioni kronologjik mbi dokumentet që aktualisht ndodhen në AQSH, mund të themi se ato fillojnë që në kohën kur Ismail Qemali ishte një nëpunës i administratës osmane, për të vijuar me dokumente që i takojnë periudhës së lëvizjes për pavarësi e përtej, e duke shkuar e deri tek ceremonia mortore pas vdekjes së tij.

Korrespondencat me persona të ndryshëm, apo shkëmbimet shkresore mes tij dhe aparatit qendror të administratës osmane datojnë në shek XVIII. Në vitin 1897, kohë kur ai ishte guvernator i përkohshëm i Tripolit, ekziston një korrespondencë ku, ndër të tjera, bëhet fjalë për gjendjen e rëndë në të cilën ndodhej ky aparat shtetëror dhe reformat e thella që duheshin ndërmarrë për përmirësimin e situatës së administratës osmane. Vazhdohet me fermane të Sulltanit për emërime dhe dekorime, ku përfshihet dhe Ismail Qemali (*fermani është në emër të Sulltanit i cili i jep këtë të fundit dekoratën "Mexhide"*).⁷

Nuk mungojnë dokumente që tregojnë se si administrata e sulltanit kishte dërguar agjentët e vet për të përhapur lajme se I. Qemali, i cili në atë kohë ishte në Qytali, kishte marrëveshje të fshehta me qeverinë ruse, gjë ndikonte tek popullsia vendase për të mos e parë me sy të mirë, duke vazhduar me dokumente të tjera që lidhen po me këtë periudhë.⁸

Për vitin 1908, një vit i komplikuar për Ballkanin, ku nuk mund të përjashtohet Shqipëria, ekzistojnë dokumente ku vetë I. Qemalit përshkruan gjendjen e rëndë në të cilën ndodhej vendi, dhe që sipas tij mund të ndryshohet vetëm me ndërhyrjen e fuqive evropiane, të cilat sipas tij do ta detyronin Sulltanin të zbatonte vendimet e Kongresit të Berlinit. Mes tyre është dhe kopja e një letre (prill 1908) që I. Qemali i dërgon Eduard Grejt dhe z. Pishman, ministrave të punëve të jashtme të Anglisë dhe të Francës, ku i kërkon që reformat të bëhen në të gjithë Turqinë Evropiane, pra dhe në Shqipëri. Në të bëhet fjalë për çështjen shqiptare dhe përfilljen e saj në arenën ndërkombëtare.⁹

“Do të duhet medoemos që popullit shqiptar t’i njihet ekzistenca e tij kombëtare, shkruan I. Qemali, t’i jepen mjete për ngritjen dhe zhvillimin e tij, me qëllim që në harmoni të plotë me banorët e kombësive të tjera, të hyjë në rrugën e përparimit¹⁰”.

⁷ AQSH, Fondi 20, Dosjet nr. 2, dt. 16.09.1885, 22.04.1900.

⁸ Koli Xoxi, *Ismail Qemali, Jeta dhe vepra*, fq. 79.

⁹ AQSh. Fondi 20. Dosja 3.

¹⁰ Koli Xoxi, *Ismail Qemali, Jeta dhe vepra*, fq. 150

Në vitin 1909 ka një sërë telegramesh që flasin mbi qëndrimet e patriotëve shqiptar, drejtuar qeverisë osmane, ku protestohet edhe ndaj atentatit dhe veprimeve të tjera kundër jetës I. Qemalit, si dhe patriotëve të tjerë shqiptarë¹¹. E njëjta gjë do të përsëritet dhe në vitin 1911 ku, sipas dokumenteve të këtij fondi, “në muajin mars 1911, gjatë një diskutimi në parlament, një nga bejlerët i ra me grusht I. Qemalit”.¹² Kësaj periudhë i përkasin dhe shumë materiale me karakter thjeshtë familjar¹³.

Korrespondenca e I. Qemalit me institucione të ndryshme gjendet e pasqyruar edhe gjatë viteve në vazhdim.¹⁴ Në fillim vitin 1912 dhe në vazhdim dokumentet arkivore ruajnë dhe kopje të dorëshkrimeve nga individë të ndryshëm, kujtime etj., të gjitha lidhur me veprimtarinë e Ismail Qemalit, përgatitjet që po bëheshin për shpalljen e pavarësisë, mbështetjet që ato tregonin ndaj këtyre përgatitjeve etj, si në rastin e një kartë-postale të kryetarit të Bashkisë Samengo, dërguar komitetit “pro alban” ku që para shpalljes së pavarësisë njoftohet se populli i qytetit Lungro dhe administrata e kësaj bashkie i ka telegrafuar I. Qemalit duke i uruar bashkimin, lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë¹⁵. Nuk mungojnë dhe dokumentet që kanë të bëjnë me vendimet e mbledhjes së Bukureshtit¹⁶.

Në fondin e I. Qemalit dhe atë të Kryesisë së Qeverisë së Përkohshme ka dëshmi arkivore që pasqyrojnë bashkëveprimet ndërmjet shqiptarëve të të gjithë krahinave shqiptare, duke mos përjashtuar këtu dhe shqiptarët që jetonin në mërgim. Në to reflektohen shqetësimet e I. Qemalit mbi gjendjen e tensionuar politike në vilajete shqiptare, (*Pika për të cilën duhet të na vijë keq, i shkruan ai një mikru nga Korfuzi, është se paria e atdheut tonë, të cilës s’është për t’i besuar tepër, nuk interesohet për gjendjen e Shqipërisë*)¹⁷, gjë që e shtynte atë të mendonte se për çështjen kombëtare duhej trokitur në dyert e Evropës (Fondi 20, D. 17, fl. 1)¹⁸.

Janë të arkivuara në këtë fond dhe raporte të hollësishme dërguar I. Qemalit nga bashkëpunëtorët e tij, që flasin për gjendjen politike dhe ushtarake të krahinave të ndryshme përfshirë këtu Kosovën, Dibrën, dhe Shkodrën, të cilat i përkasin pranverës së 1912. Njësoj siç mendonte dhe I. Qemali, edhe në këto raporte kërkohej që problemi shqiptar t’i bëhej i ditur botës së qytetëruar, pasi

¹¹ AQSH, Fondi 20, Dosja 2, dt. 8.3. 1909.

¹² AQSH, Fondi 20, Dosja 7, dt. 1912.

¹³ Letër njoftim i bashkëshortes, leja e qarkullimit e djalit të tij, lëshuar nga drejtoria që merrej me punën e popullsisë në vilajetin e Bilishtit. AQSH, Fondi 20, Dosja 2, dt. 3.8.1891, 2.7.1908.

¹⁴ AQSH, Fondi 20, Dosja 16, dt. 28.09.1912, (5 faqe). Letra të I.Q. drejtuar Prefekturës së Beratit, Prefekturës së Durrësit e Prefekturës së Dibrës.

¹⁵ AQSH, Fondi 20, Dosja 29, dt. 7.12.1912.

¹⁶ AQSH, Fondi 20, Dosja 20, vitit 1912, 40 faqe.

¹⁷ Koli Xoxi, *Ismail Qemali, Jeta dhe vepra*, fq. 28.

¹⁸ U.T. Instituti I Historisë, *Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek XX* (përmbledhje studimesh), fq. 46. Shtypsh. KLEAN. Tiranë 2008. (AQSH, Fondi 20, Dosja 17, fl. 1.)

nuk mjaftonte vetëm lufta e armatosur për liri dhe mëvetësi, por edhe përkrahja e të Mëdhenjve¹⁹. Në këto korrespondenca dhe raporte mbi qëndresën e armatosur të popullit shqiptar kundër pushtuesit Osman, I. Qemali nuk harronte të kujtonte edhe për përdorimin e shkrimit shqip në korrespondencën ndërmjet kryengritësve.²⁰

Në gusht të viti 1912, I. Qemali ndodhej në Trieste²¹. Kjo dëshmohet dhe nga dhe nga një letër e I. Qemalit dhe Luigj Gurakuqit, që ruhet në Fondin 20²², që i drejtohet Refik dhe Masar Toptanit, ku pasi informonin se parlamenti ishte shpërndarë dhe qeveria kishte dhënë dorëheqjen, theksonin se duhet punuar që të nxirren të gjitha të drejtat. *Të mos gënjejemi edhe një herë, vazhdon letra, por të mbajmë vendet që kemi, të forcobemi dhe të lidhemi me njëri tjetrin e të ngulim këmbë që t'i jepen katër vilajeteve ato 12 nyjet që kishin kërkuar vjet nga ana e malësorëve... dubet që nga të gjitha anët e Shqipërisë të dërgohen njerëz në Kosovë që të rrëfejnë se si me armë, si me mendim, si me kërkime jemi që të gjithë shqiptarë të pandarë... në qoftë se do qëndrojmë si burrat e nuk kënaqemi me fjalë të thata, në qoftë se ngulim këmbë në kërkimet tona, do të mbetemi të fortë e do të mbarojmë dëshirat tona, pa derdhur gjak tjetër, përndryshe do na shkojnë kot mundimet tona që hoqëm*²³.

Sipas dokumenteve të Dosjes 12, Fondi 20, në kohën që Ismail Qemali arrin në Bukuresht, së bashku me Luigj Gurakuqin, pasi u largua nga Stambolli, në dt. 26 tetor 1912, ai e dinte se qeveria Rumune do ta përkrahte pavarësinë e Shqipërisë për interesat e saj. Sipas dokumenteve Ministri i jashtëm i Rumanisë, Take Jonesku u tregua përkrahës i lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe e siguroi se Rumania do ta ndihmonte.

Duke kaluar në prag shpalljen e pavarësisë është Dosja 12, dokumentet e së cilës flasin për qytetin ku I. Qemali mendonte se mund të zhvillohej mbledhja e Kuvendit Kombëtar. Në fillim u mendua për Durrësin si më në qendër të trojeve shqiptare, por dhe sepse forcat serbe do e kishin të vështirë të depërtonin në të.

Për sa i përket momentit të shpalljes së pavarësisë, dokumentet gjenden kryesisht në Fondin 145, që i përket Kryesisë së Përgjithshme të Qeverisë së Vlorës.

Në një raport të një nëpunësi të Ministrisë së Jashtme të Austro-

¹⁹ Po aty, fq. 48. (AQSH, Fondi 20, Dosja 4, fl. 40-41.)

²⁰ AQSH, Fondi 20, dok. dt. 10.7.1911.

²¹ Qeveria e xhon turqve kishte dhënë dorëheqjen, Parlamenti Osman qe shpërndare. Shkak dhe kryengritjet e shqiptarëve. Qeveria e re turke do të bëjë përpjekje që përpara shpërthimit të Luftës Ballkanike të pajtohej me kryengritësit...

²² AQSH, Fondi 20, Dosja 3, viti 1912.

²³ Koli Xoxi, *Ismail Qemali, Jeta dhe vepra*, fq. 226.

Hungarisë, z. Alfred Rapapori ²⁴, vihet në dukje se shpallja e pavarësisë prej I. Qemalit në 28 nëntor, “*ka qenë kushti kryesor për ndryshimin e planeve rrënuese kundrejt Shqipërisë... ai diti të zgjedhë në mënyrë gjeniale, vendin dhe kobën për veprën e madhe diplomatike*”²⁵.

Në fondin e I. Qemalit ka dokumente që lidhen edhe me periudhën e pas shpalljes së pavarësisë. Është një letër e tij dërguar ministrave të punëve të jashtme të fuqive të mëdha, dhe ministrit të punëve të jashtme të Italisë, me të cilën përshëndet vendimin e fuqive të mëdha për përcaktimin e kufijve, duke shprehur dëshirën e shqiptarëve për të gëzuar të mirat e paqes, dhe duke shprehur keqardhjen për zgjatjen e luftës Greqi-Turqi, teatri i së cilës është Shqipëria, që shkakton shkatërrime të qyteteve dhe fshatrave, përhap sëmundje dhe epidemi, etj. Ai i bën apel drejtësisë së këtyre fuqive duke ju lutur të ndërhyjnë për t’i dhenë fund luftës, duke ruajtur, kështu, Shqipërinë dhe Shqiptarët²⁶.

Ka kopje të letrave të I. Qemalit, tashmë kryetar i qeverisë shqiptare, drejtuar komisionit ndërkombëtar në Shkodër²⁷. Kopje të letrave drejtuar prefekturës Berat, Prefekturës së Durrësit dhe Prefekturës së Dibrës. 28.12.1912 5fq. Letër për dërgimin e forcave në Lushnjë, 1.10.1913. Letër e (B) Godës dërguar nga Lozana, Pandeliut në Vlorë ku jepen mendime lidhur me situatën politike dhe I. Qemalin (13.11.1913)

Më 22 janar 1914 I. Qemali jep dorëheqjen. Përballë këtij akti janë ruajtur telegrame dhe letra nga përfaqësues të zonave të ndryshme si, p.sh., telegrami i përfaqësuesve të popullit të Lushnjës më 23 janar 2014, e kështu me radhë.

Në vitet në vazhdim në po këtë fond ruhet letra që mban datën 18.07.1912, që ka një përmbajtje më shoqërore, siç është letra e një francezi ku falënderon për ndihmën e dhënë nga I. Qemali, etj.

Fondi mbyllet me letrën e Qazim Kokoshit dt. 13.11.1919, drejtuar Bashkisë së Elbasanit ku flitet për ceremoninë e varrimit të Ismail Qemalit, raportin autopsisë, pjesë nga ditari i komandës së lartë të forcave italiane në Ballkan mbi funeralin e tij në Vlorë, e kështu me radhë²⁸.

Të gjithë këto dokumente që i përkasin Fondit 20 ruhen në formën e dorëshkrimeve, por dhe të daktilografuara. Mbetet detyrë për të ardhmen që ky fond të pasurohet edhe me dokumentacione që mund të jenë të shpërndara në fonde të tjera, duke lehtësuar kështu dhe punën e studiuesve shqiptarë dhe të huaj që mund të kërkojnë të studiojnë mbi jetën dhe veprën e kësaj figure të rëndësishme për kombin tonë.

²⁴ AQSH, Fondi 20, Dosja 12.

²⁵ Koli Xoxi, *Ismail Qemali, Jeta dhe vepra*, fq. 265.

²⁶ AQSH, Fondi 20, Dosja 20, dt. 24. 12. 1912.

²⁷ AQSH, Fondi 20, Dosja 16, dt. 11.09.1913.

²⁸ AQSH, Fondi 20, Dosja 20.

Bibliografi:

Burime parësore:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë, Fondi “Ismail Qemali”,
nr. 20.

Burime dytësore:

Luarasi, Skënder: *Ismail Qemali, Jeta dhe vepra*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”,
Tiranë 1962.

Universiteti i Tiranës, Instituti I Historisë: *Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit
shqiptar gjatë shek XX* (përmbledhje studimesh). KLEAN, Tiranë
2008.

Xoxi, Koli: *Ismail Qemali, Jeta dhe vepra*, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë 1983.

